



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA FIER**  
**DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT**  
**SEKTORI I PYJEVE**

Nr. 3831 Prot

Fier më 25/03/2026

**Projekt - Vendim**

Nr. 33 datë 25/03 /2026

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN E PYJEVE NGA ZJARRI, PËR BASHKINË FIER PËR VITIN 2026.**

Në mbështetje të nenit 30 , pika “4” , gërma “c” të ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, të ndryshuar , nenit 27 , pika “5”, neni 54 , gërma “k”, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” , të ndryshuar , V.K.M – së nr. 1080 datë 22.12.2010 “Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”, si dhe për krijimin e Njësave Vullnetare të shuarjes së zjarreve, , Kryetari i Bashkisë ,

**Propozon:**

1. Miratimin e “Planit të masave për mbrojtjen kundër zjarrit” dhe “Planit të Veprimit”, për Bashkinë Fier, për vitin 2026;
2. Për zbatimin e këtij vendimi si dhe për ndjekjen e procedurave të mëtejshme, administrative-ligjore ngarkohet Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit , Sektori i Pyjeve, pranë Bashkisë Fier.

**Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit**

**Sektori i Pyjeve**

Ing. Ildo Trifoni

**Drejtoria Juridike**

Esmeralda Kapllanaj

**KRYETARI**

**Armando Subashi**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**ZËVENDËS KRYETARI**

**Eraldi Qirio**






REPUBLIKA E SHQIPËRISE

N. 3565

14.13.03.2026

BASHKIA FIER  
DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT  
SEKTORI I PYJEVE

MIRATOHET  
KRYETARI  
ARMANDO SUBASHI



PLANI I MASAVE  
PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRI  
PËR VITIN 2026

Baza ligjore :

- Ligji nr.57/2020 date 30.04.2020 "Për Pyjet" neni 30.
- Ligji nr.9693 date 19.03.2017 "Për fondin kullosor" të ndryshuar
- Ligji nr.139/2015 date 17.12.2015 Për vete Qeverisjen Vendore"
- Ligji nr.152 date 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi"
- VKM-në nr.1080 date 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njesive vullnetare të shuarjes së zjarreve".

Për parandalimin dhe shuarjen në kohë të zjarreve në pyje dhe kullota Drejtoria e Pyjeve në Bashkinë Fier përgatit këtë plan masash :

Nr	Përshkrimi i objektivit që duhet të realizohet	Përshkrimi i masave që do të mërren në zberthim të objektivit	Afatet e përmbushjes së çdo mase	Përcaktimi i treguesëve konkret për vlerësimin e realizimit të çdo mase	Kush ngarkohet për realizimin e masave
1	Plani veprimeve parandaluese për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota	Të ngrihen shtabet e MNZSH për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri pranë Njësive Administrative. Në përbërje të shtabeve të jetë dhe një përfaqësues i sektorit të pyjeve dhe kullotave.	30.04.2026	Bënë vlerësimin konkret të situatës së krijuar, merrë vendime dhe masa të nevojshme që kanë si objekt përmirësimin e punës. Ushtron kontrole të vazhdueshme për zbatimin e masave për mbrojtjen nga zjarri. Harton planin e veprimit	Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit Sektori I Pyjeve
2	Sensibilizimi i komunitetit	Te përgatitet një material prezantues me temën RREZIKU DHE MBROJTJA NGA ZJARRI Te përgatiten fletëpalosje për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.	30.05.2026	Prezantohet materiali me të gjitha palët e interesuara, bizneset, fermerët, pronarët privat, komuniteti i zonës	Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit Sektori I Pyjeve  Drejtoria e shërbimeve
3	Ngritja e skuadrave vullnetare të MZSH - së	Mbi bazën e VKM 1080, datë 22.12.2010. "Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve" dhe të ligjit nr.152, datë 21.12.2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" neni 13, të organizohen skuadrat vullnetare të gadishmerisë për MNZSH.	30.05.2026	Organizohen njësi vullnetare për shuarjen e zjarreve në çdo fshat dhe Njësi Administrative	Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit Sektori I Pyjeve Njësitë Administrative

4	Ngritja e sistemit te vrojtim sinjalizimit	Mbi bazen e VKM 1080, date 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësisive vullnetare të shuarjes së zjarreve" pika I gërma b	30.04.2026	Vrojton dhe sinjalizon ne rastet e zjarreve	Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit Sektori I Pyjeve
5	Përdorimi i burimeve njerëzore, materialeve financiare dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore	Drejtoria e pyjeve shpërdan menjëherë hartën e rrezikut nga zjarret për pyjet me rrezikshmëri të lartë. Vëmendje të veçantë duhet të tregohet në pyjet me vlera turistike, në zonat e brezit pyjor mbrojtës bregdetar, të merren masa suplementare shërbimi kundër zjarrit, sidomos për ditët e shtuna dhe të dielës, duke disiplinuar levizjen e turistëve dhe të mjeteve.	Ne vazhdimësi	Sistemi i informimit me telefon të jetë aktiv, mjetet të jenë në gjendje të funksionit të shuarjes së zjarreve. Bashkëpunimi me MNZSH në rast konstatimi të zjarrit. Të zbatohet me korrektosi rregullorja e mbrojtjes së pyjeve dhe kullotave nga zjarri.	Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit Sektori I Pyjeve  Njesit Administrative MNZSH
6	Informimi i publikut	Do organizohet takime sensibilizuese dhe spote publicitare për ndergjegjësimin e opinionit publik për dëmet që shkaktojnë zjarret në pyje dhe kullota dhe nevojën e bashkëpunimit në procesin e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve.	Ne vazhdimësi	Të prodhohen postera dhe fletëpalosje të shoqëruara me problematiken e zjarreve në pyje. Të kontaktohen TV lokale për dhënie spotesh dhe tema për shuarjen e zjarreve.	Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit Sektori I Pyjeve  Emergjencat Civile  Njesit Administrative

7	Kontrolle operative	Per zbatimin e ketij program masash ngarkohen Drjetoria e Pyjeve. Njesit Administrative. MNZSH. Emergjencat Civile	Ne vazhdimesi	Të merren masa parandaluese ne kohën e duhur per rritjen efektiv te punës në rastet e zjarreve	Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit Sektori I Pyjeve Njesit Administrative MNZSH Emergjencat Civile
8	Përdorimi i aplikacionit Smart Forest Disaster	Do organizohen takime ne Njesit Administrative per trajnimin e publikut se si perdoret aplikacioni	Ne vazhdimesi	Trajnimi do behet nga Drejtoria e Pyjeve ne Njesit Administrative	Drejtoria e Pyjeve dhe Mjedisit Sektori I Pyjeve  Njesit Administrative

PËR DREJTORINË E PYJEVE DHE MJEDISIT

SEKTORI I PYJEVE

Inspektor Pyjesh

Ing. Ildo Trifoni



Specialiste Pyjesh

Ing. Roventa Sera



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr 3564

04.10.2026

BASHKIA FIER  
DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT  
SEKTORI I PYJEVE

MIRATOHET  
KRYETARI  
ARMANDO SUBASHI

PLAN VEPRIMI

Për Mbrojtjen e pyjeve dhe Kullotave nga Zjarri

Për vitin 2026

Në zbatim të ligjit nr 57/2020 "Për Pyjet", neni 30; ligji nr 9693 datë 13.09.2007 "Për fondin kullor" të ndryshuar, V.K.M nr.1080 datë 22.12.2010 "Për rregullat dhe parandalimin e shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota si dhe krijimin e njësive vullnetare për shuarjen e zjarreve" si dhe në zbatim të Planit të Masave të miratuar nga Kryetari I Bashkisë , Drejtoria e Pyjeve harton këtë Plan Veprimi :

1. Krijimin e shtabeve të M.N.Z – së për çdo Njësi Administrative.
2. Krijimin e njësive vullnetare për shuarjen e zjarreve në çdo fshat.
3. Të bëhen listat me numrat e telefonit për çdo kryetar fshati dhe anëtarët e njësive vullnetare
4. Shpërndarja e fletëpalosjeve ne qendrat e banuara mbi rrezikshmërinë dhe dëmet që shkaktojnë zjarret.
5. Prodhimin e tabelave sensibilizuese " Mbroni Pyjet nga zjarri" dhe vendosja e tyre në pikat kyçe dhe rrugëkalime.
6. Të sensibilizohet opinion public nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj visive, postera, takime me komunitetin.
7. Bashkëpunimi me Emergjencat Civile dhe caktimi I masivëve pyjor me rrezikshmëri më të lartë zjarri. ( Pyjet e Pishës)
8. Në zonat Bregdetare te Semanit dhe të Darzezës duhen mbajtur nën kontroll vizitorët, ekskursionistët gjatë vizitave të tyre në pyje e kullota.

9. Hapja e korridoreve të reja dhe pastrami i rrugëve egzistuese për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri si masë parandaluese.
10. Bashkëpunimi me Drejtorinë e MZSH dhe me Emergjencat Civile për njohjen e rrejtës rrugor të pyjeve në territorin e Bashkisë Fier.
11. Organizimi I takimeve me pronarët privatë, për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.
12. Në zbatim të VKM - së nr.1080 datë 22.12.2010 pika nr. 11, Ndermarja e mirembajtjes së rrugëve të pastrojnë skarpitet e rrugëve nga vegjetacioni I djegshëm me qëllim parandalimin e zjarreve.
13. Përdorimi I aplikacionit Smart Forest Disaster.

**PËR DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT**

**SEKTORI I PYJEVE**

**Inspektor Pyjesh**

**Ing. Ildo Trifoni**

**Specialiste pyjesh**

**Ing. Roventa Sera**

